



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI BASHKIAK DROPULL

Nr. Prot.

Jorgucat, me 31/03/2022

PROÇES-VERBAL

TAKIM MË DATË:31.03.2022

Tema: Mbledhja e radhes te Keshillit Bashkiak Dropull te muajit Mars 2022,

Ora e hapjes te mbledhjes ora 10:00

Kryetari i Këshillit ,Kryesuesi i mbledhjes është znj.Donika Bauçi.

Këshilltar të pranishëm në mbledhje:

Donika Bauçi,Dhimitër Koça,Jorgo Luleme,Vasiliqi Nika,Kristo Varsami,Maksi Qëndro,Orest MaloAlketa Basho,Luljeta Pirali,Angjeliqi Praso,Fotaq Zhonga,Kostandina Doko,Marjeta Xhumba,Elefteria Karanxha,Zhaneta Dralo.

Mungesat:Elina Dhima,Eliona Mano,Theodhori Dhima,Anastasi Iso,Llaokrat Konomi,Vjoleta Ndrico.

Kryetari Keshillit deklaroi kuorumin 15 keshilltar.

Te pranishëm në mbledhje Nenkryetari I Bashkise z.Dhefto dhe Z.Lulo,drejtorat z.Arjan Tusha dhe znj.Lindita Xhumba,Amalia Millo,z.Kristaq Lengo,juristi z.Erald Maksuti.

Te pranishem nga administrata e bashkise z.Lefter Nasto nga ujesjellesi z.Gjergji Meçi

Kyesuesi i mbledhjes: Miratojme proçesverbalin e mbledhjes se meparsheme,miratojme rendin e dites duke hequr piken 11 Projekt-vendim “Per rinovimin e kontrates me ALB-TELEKOM-Sha”,per mungese dokumentacioni, duke shtuar kerkesen per azile.

Rendi I ditës:

1. Projekt-Vendim “ Për miratimin e përfituesve te fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmes ekonomike ”.
2. Projekt -Vendim “Per miratimin e tavaneve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025”.
3. Projekt-Vendim “Për miratimin e Rregullores se mbrendshme te Bashkise Dropull”.

4. Projekt-Vendim “Për dhenie mendimi për miratimin e tarifës së ujit të pijshëm dhe shërbimin e largimit të ujërave të zeza”.
5. Projekt-Vendim ‘Për një ndryshim në vendimin nr.65, datë 25.11.2021 “Për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes së operatorëve për linjat e transportit rrethqytetas të udhëtarëve, si dhe rinovimin e licencave për këto linja” te ndryshuar.
6. Projekt-Vendim ‘Për kushtet dhe dokumentacionin që duhet të plotësojë subjekti për marrjen e licencës për agjenci transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit’
7. Projekt vendim ‘Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Dropull’
8. Projekt-Vendim ”Për riperseritje kontrate në vatrën e kultures Dervician”.
9. Projekt-Vendim “Për transferimin në pronësi të Bashkisë Dropull të pronës të paluajtshme shtetërore në fshatin Sotire ”.
10. Projekt-Vendim “Për dënimin me qira nëpërmjet procedurës së konkurrimit Publik, të pasurisë shtetërore me sipërfaqe të përgjithshme 10427 m² në zonën kadastrale 3464 fshati Skore të Njesisë Administrative Pogon.
11. Te ndryshme..Kërkese për azilë ,shoqëria e transportit ,ankese

Kryesuesi i mbledhjes:

Fillojme me pikën e parë të rendit të ditës :

Relatoni z.Lengo: Në listat e muajit Shkurt shtohet një person Kristofor N.Mastora,fshati Llongo.

Gjithësej për muajin Mars 2022 janë 68 familje me fond 193,292 lek.

Kryetari i Keshillit:Ka pyetje?pyetje s’ka,kalojmë në votim.Votojnë 15 keshilltarë pro,kundra s’ka,pra miratohet,miratohet pika e parë me listatë përfituesve. bashkangj.procesverbalit.

Pika e dytë “Për miratimin e tavanëve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025”.

I jepet fjala z.Lengo I cili relatoni:Sipas programit buxhetor të ardhurat për vitin 2022 janë 71,918 për vitin 2024 janë në vlerën 72,640 leke,të ardhurat për vitin 2025 janë 72,755 leke.

Z.Lengo foli për objektivat dhe sfidat që përballon Bashkia.

Diskutoni Kryetarja Keshillit :Në muajin Shkurt-Mars keshilli Bashkiak ,hartoi një sondazh përmes të cilit ka mbledhur rekomandime të komunitetit mbi funksionet prioritare të Bashkisë,sondazhi ka qenë online për rreth një muaj.

Keshilli bashkiak analizoi rezultatet e sondazhit,të ku mbështetje për zhvillimin ekonomik,turizmin dhe tregjet mbi 50% të komunitetit.

Nderhyne Dhimiter Koça :Duke u zhvilluar turizmi ne zonen tone do te sjellim turiste,duke ndihmuar bizneset ketu.

I jepet fjala znj.Marjeta Xhumba:Te reklamohen zonat turistike nga zyra e turizmit te bashkise si kishat,apo dhe zona te tjera turistike dhe propozoje që ne mbledhjen e radhes te vendoset ne rendin e dites raport nga zyra turistike.

Hedhim ne vote piken e dyte te rendit te dites 15 vota pro,kunder s'ka,miratohet .

Kalojme te pika 3 Projekt-Vendim “Për miratimin e Rregullores se mbrendshme te Bashkise Dropull”.

Relaton drejtore e Burimeve Njerezore znj.Amalia Millo:Ne rregullore jane shtuar funksione dhe detyrat neni .,III per IMT.

Hedhim ne votim,miratohet pika 3 e rendit te dites.

Pika e 4 e rendit te dites Projekt-Vendim “Për dhenie mendimi per miratimin e tarifës së ujit të pijshëm dhe shërbimin e largimit të ujërave të zeza”.

Relaton Gaqe Meçi

Vete amortizimi i ujesjellesit duhet te realizohet nga te ardhurat e ujesjellesit ,duhet te ndryshojne tarifat per kete vit, kemi nje propozim qe klientet familjaret te jete tarifa 46 leke per m/3,56 leke per m/3,kliente publik, 60 leke m/3 kliente privat.

Hedhim ne vote propozimine shoqerise se Ujesjellesit sh.a Dropull,miratohet mendimi ne parim i ujesjelles kanalizim Dropull sh.a.

Hedhim ne vote,votojme 15 keshilltare,pra miratohet pika 4.

Pika 5- Projekt-Vendim 'Për një ndryshim në vendimin nr.65, datë 25.11.2021 “Për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes së operatorëve për linjat e transportit rrethqytetas të udhëtarëve, si dhe rinovimin e licencave për këto linja”te ndryshuar

Kryetarja :Jeni dakort me ndryshimet ne vendimin nr.65?

Kundra s”ka,pro 15 keshilltare,miratohet.

Pika 6 e rendit te dites; Projekt-Vendim ‘Për kushtet dhe dokumentacionin që duhet të plotësojë subjekti për marrjen e licencës për agjenci transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit’

Kryetarja e keshillit:Jeni dakort me me kriteret qe duhet te plotesoje subjekti?

Kundra s’ka,miratohet .

Pika 7 e rendit te dites Projekt vendim ‘Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Dropull’

Votojne te gjithë per miratimine rregullores,pra miratohet.

Pika 8 e rendit te dites Projekt-Vendim ”Per riperseritje kontrate ne vatren e kultures Dervician”.

Kontrata ishte ne emrin e burrit Mihal Ndirco,pas vdekjes te burrit kontrata do te rinovohet ne emer te gruas.

Votojne te gjithë keshilltaret pro.

Miratohet pika 8 me 15 vota pro ,kundra s’ka.

Pika 9 Projekt-Vendim “Per transfermimin ne pronesi te Bashkise Dropull te prones te paluajtshme shteterore ne fshatin Sotire ”.

Relaton Arjan Tushe :Per te dhene me qera Bashkia duhet te marre statusin juridik dhe pastaj te bej kontraten me qera.

Votojne 15 keshilltare per piken 9 pro,miratohet.

Pika 10 e rendit te dites Projekt-Vendim “Për dhenien me qira nëpërmjet procedurës së konkurrimit Publik, të pasurisë shtetërore me sipërfaqe te pergjithshme 10427 m² ne zonen kadastrale 3464 fshati Skore te Njesise Administrative Pogon.

Kryetare e keshillit:Hedhim ne vote 15 keshilltare votojne pro,miratohet.

Pika 11 kerkese e administratorit te ndihmes per znj.Eleni Çuni per ne Shtepine e te moshuareve ne Gjirokaster .

Votojne 15 keshilltare pro,kundra s’ka.Miratohet kerkesa.

Kerkese per ndryshimin e linjes te stacionit nga Jorgucati ne Kakavi,Keshilltaret jane te mendimit te vendoset perpara linja e brendshme dhe pastaj te ndyshimi i stacionit.

Per mbledhjen e ardheshme raport per tuzimine ,miratimin e ndihmes ekonomike.

Mbledhja deklarohet e mbyllur.